



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS I.**

---

Numri i lëndës: 2022:184275

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04977024

**PPP.nr.11/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA I. DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A me seli në Prishtinë rr. Nëna Terezë nr.36, ndaj debitorit Xh.O nga fshati G. Komuna I., në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike për periudhën kohore nga data 04.10.2010 deri me datën 20.03.2013, baza juridike borxh në shumë prej 770.15 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.642/18 i datës 20.12.2018, jashtë seancës gjyqësore me datë 27.11.2023 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET I PABAZUAR**, prapësimi i debitorit Xh.O nga fshati G. Komuna I., i parashtruar kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.642/18i datës 20.12.2018.

**II.** Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në gjykatë në shumë prej 770.15 euro.

**III.** Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

**A r s y e t i m**

Kreditori, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit me datë 20.012.2018 të Përmbaruesi Privat, në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike për periudhën

kohore nga data 04.10.2010 deri me datën 20.03.2013, baza juridike borxh në shumë prej 770.15 euro.

Përmbartuesi privat duke vendosur ne bazë te propozimit ka caktuar urdhrin për përmbartim P.nr.642/18 të datës 20.12.2018.

Debitori, në afatin e paraparë ligjor me datë 31.12.2018 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhëri përmbartimor duke u thirr në parashkrimin e borxhit.

Kreditori ne afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapsim, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar.

Gjykata në vendosjen e kësaj çështje përmbartimore pas shqyrtimit dhe vlerësimit te prapësimit te debitori, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe shkresave tjera të lëndës ka konstatuar se prapësimi nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, ne bazë të të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Me propozimin për përmbartim, kreditori ka kërkuar nga debitori borxhin në shumë prej 770.15 euro, për periudhen kohore nga data 04.10.2010 deri me datën 20.03.2013.

Nga shkresat e lendes rezulton se kreditori dhe debitori me datën 13.06.2017 kanë lidhur kontratë nr.55024 për pagesën e borxhi me anë të kësteve dhe deklaratë mbi dakordimin e borxhit për pagesen e borxhit me 12 këste.

Nga ekstrakti i verifikuar nga libra afaristë për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike vërehet se debitori ka paguar 5 këste në shumën nga 21.00 euro, dhe të fundit me datë 02.02.2018. Por meqenëse debitori ka rënë ne vonesë më shumë se tre muaj, kreditori me datën 20.12.2018 ka parashtruar propozimin për përmbartim duke kërkuar borxhin prej 770.15 euro, (duke llogaritur pagesat e bëra nga debitori) ngase me nenin 3 të kontratës nr. 55024 të datës 13.06.2017 është përcaktuar së: në raste se përfituesi shkakton tri vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit nëse ka fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe gjitha ndëshkimet.

Prandaj meqenëse neni 3 i kontratës në fjalë është në përputhje të plot me dispozitën ligjore të nenit 6 par. 3 të Ligjit nr. 05/L -043 për faljen e borxheve publike i cili përcakton se: pavarësisht dispozitave të nenit 4 të këtij ligji, nëse personat të cilët përfitojnë nga ky ligj përmes arritjes së marrëveshjes për pagesën me këste të obligimeve për periudhën 1 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, dështojnë në respektimin e kushteve të marrëveshjes, atëherë, Institucioni Shtetëror apo Ndërmarrja Publike ka përgjegjësi që të njëjtin ta vendosë në listën e borxheve, duke e bërë obligues për të gjitha borxhet e mbetura sipas kërkesave ligjore që kanë qenë të zbatueshme para

lidhjes se marrëveshjes, për çka gjykata ka gjetur se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Lidhur me pretendimin e debitorit në prapësim, se borxhi i cili është kërkuar është parashkruar, sipas vlerësimit të gjykatës, i njëjti pretendim ishte i pabazuar, ngase pagesat e borxhit e bëra nga debitori me këse sipas marrëveshjes nr.55024 dhe programit për pagesën e borxhit, të arritur në mes të kreditorit dhe debitorit, kanë ndërprerë parashkrimin, konform nenit 368 të LMD, paragrafët 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin; 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.*

Andaj, meqenëse kreditori i ka llogaritur pagesat e bëra me anë të kësteve nga debitori të cilat pagesa nuk i ka kërkuar me propozim, gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar ngase, debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimi sipas dokumentit të besueshëm në bazë të së cilit kërkohet borxhi në shumë prej 770.15 euro, e duke ju referuar nenit 69 par. 4 të LPP-së i cili shprehimisht përcakton se: *baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet, vendosi që ta refuzoj prapësimin.*

Gjykata i analizoi dhe shqyrtojë edhe pretendimet e tjera të debitorit të ushtruar me prapësim kundër propozimit për përmbarim të kreditorit, mirëpo gjykata nuk ua fali besimin sepse nuk ishin të mbështetura në prova relevante e as pretendimet e theksuara në prapësim nuk ishin të argumentuara, e duke pasur parasysh faktin se debitorit nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se i njëjti ka paraqitur ndonjë ankesë ndaj kreditorit për faturën e lëshuar nga kreditori, gjykata ka gjetur se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me dispozitën ligjore të nenit 29 par. pika 1.2 të LPP-së është përcaktuar se: *përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm, e dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është edhe ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave e në bazë të cilit e ka mbështetjen ligjore urdhri për përmbarim.*

Në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoi garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit e të cilat janë parapa në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke iu referuar nenit 73 të LPP-së, e lidhur me nenin 245 par.1 dhe 2, të LMD-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Civil**  
**PPP.nr.11/19, datë 27.11.2023**

**Gjyqtarja**  
Pajtesë Boshnjaku

**Udhëzim juridik:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.